

Programi i Shkencave Shëndetësore për Profilet Terapeutike

Rezultatet e të nxënit

a. Rezultatet ndër-profesionale të të nxënit:

- Të përgjithshme: njohuri mbi praktikat e kujdesit shëndetësor, aftësi për zgjidhjen e problemeve dhe marrjen e vendimeve, qasje të orientuar tek klienti, aftësi për të integruar trendet aktuale, teknologjinë dhe inovacionin. Përdorimi i teorive, modeleve, qasjeve dhe koncepteve.
- Vlerësimi: njohuri për gjendjet shëndetësore dhe sëmundjet, aftësi praktike dhe kryerja e vlerësimeve në mënyrë të sigurt, aftësi për të njohur shenjat paralajmëruese ("red flags"), sigurimi i rehatisë dhe dinjitetit të pacientit, ofrimi i një diagnoze profesionale.
- Ndërhyrja: proces profesional, arsyetim klinik, praktikë e bazuar në evidencë, qasje holistike sipas ICF, komunikim me profesionistë të tjerë, pacientë dhe kujdestarë.
- Profesionale dhe ndërprofesionale: Kodi i etikës profesionale dhe çështjet ligjore, avokimi i profesionit, dokumentimi, puna në ekipe multiprofesionale/ndërdisiplinare.
- Promovimi dhe parandalimi i shëndetit: lehtësimi i ndryshimeve të sjelljes shëndetësore, strategjitë e promovimit dhe parandalimit të shëndetit.
- Kërkimi shkencor dhe evidenca: analizimi i evidencës së disponueshme dhe integrimi i saj në praktikën klinike, kërkimi i literaturës shkencore relevante dhe aftësia për të realizuar një hulumtim.
- Edukimi dhe të nxënit: vetëvlerësimi i praktikës, zhvillimi profesional dhe të nxënit gjatë gjithë jetës, mbikëqyrja klinike e studentëve të ciklit të parë, të nxënit e përbashkët me profesionistë të tjerë.

b. Rezultatet e të nxënit për profilin Logopedi:

- Studentët e diplomuar duhet të jenë në gjendje të veprojnë në një gamë të gjerë kontekstesh specifike duke përfshirë kujdesin shëndetësor, parandalimin dhe edukimin, trajtimin e nevojave të klientëve për kujdesin logopedik, kryerjen e detyrave në proceset diagnostike dhe terapeutike, koordinimin, raportimin, dokumentimin dhe kryerjen e detyrave të lidhura me zhvillimin e praktikave.
- Logopedët profesionistë do të jenë në gjendje të punojnë në ekip dhe të marrin përgjegjësi për procesin e terapisë së të folurit dhe gjuhës.
- Aftësi dhe njohuri për të ushtruar punën në përputhje me parimet moderne të shëndetit, me theks në individualitetin, pjesëmarrjen aktive, partneritetin dhe qasjen holistike ndaj pacientëve si individë, familjeve të tyre ose grupeve.
- Aftësia për të njohur nevojat e individëve me probleme në nivelin e pacientit apo popullatës, për të përcaktuar objektiva dhe për t'i planifikuar, zbatuar dhe vlerësuar ato.
- Aftësia për të qenë pjesë e një ekipi shëndetësor dhe për ta udhëhequr atë. Aftësia për të krijuar një identitet profesional pozitiv dhe për të kuptuar e pranuar perceptimin e

profesionit të logopedisë, gjë që do të rrisë motivimin për rolin e logopedisë në botën e zhvilluar.

- Aftësia për të planifikuar dhe zbatuar detyra në programet diagnostike dhe terapeutike për trajtimin e pacientëve, në bazë të kualifikimeve.

c. Rezultatet e të nxënit për profilin Ergoterapi:

- Njohuri mbi kodet etike profesionale të terapisë okupacionale.
- Njohuri mbi procesin e praktikës në terapisë okupacionale.
- Njohuri mbi gjendjet shëndetësore dhe ndikimin e tyre në performancën okupacionale.
- Njohuri mbi aktivitetet e shëndetshme gjatë gjithë jetës.
- Njohuri mbi metodat e kërkimit shkencor për të përdorur burime digjitale, njerëzore dhe mjedisore në të nxënë dhe praktikë.
- Njohuri mbi teoritë, modelet, qasjet dhe konceptet bazë të terapisë okupacionale.
- Njohuri mbi metodat bashkëpunuese në mjediset e të nxënit dhe praktikës.
- Njohuri mbi trendet aktuale në praktikën e terapisë okupacionale.

Aplikimi:

- Zbatimi i kodeve etike profesionale të terapisë okupacionale në mjediset e të nxënit dhe praktikës.
- Zbatimi i procesit të terapisë okupacionale në praktikë.
- Zbatimi i njohurive të arsyetimit klinik në vlerësimin e performancës okupacionale.
- Zbatimi i aftësive të mendimit kritik në vlerësim, përcaktimin e objektivave dhe planet e trajtimit.
- Zbatimi i metodave të kërkimit gjatë detyrave të të nxënit dhe praktikës.
- Zbatimi i teorisë, qasjeve dhe koncepteve të terapisë okupacionale bazuar në modelet e praktikës.
- Zbatimi i përpjekjeve bashkëpunuese në mjediset e të nxënit dhe praktikës.

Demonstrimi i vazhdueshëm:

- Integritetit profesional në praktikën e terapisë okupacionale.
- Përdorimit efektiv të burimeve digjitale, njerëzore dhe mjedisore.
- Përdorimit të teorisë, modeleve, qasjeve dhe koncepteve të terapisë okupacionale.
- Praktikës efektive të të gjithë procesit të terapisë okupacionale.
- Mendimit kritik dhe arsyetimit në vlerësimin okupacional, përcaktimin e objektivave dhe ndërhyrjet terapeutike.
- Bashkëpunimit efektiv multidisiplinar në mjediset e të nxënit dhe praktikës.
- Qasjes së orientuar tek klienti dhe përdorimit efektiv të vetes terapeutike për të nxitur përfshirjen e klientit në aktivitete okupacionale.